



Organizata jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe

EC MA NDARYSHE

20 qershor 2018, Prizren

Komunikatë

Evidentohen tejkalime të reja në rindërtimin e Teqes në Marash


Punimet për rindërtimin e Teqes, të cilat janë duke u zhvilluar brenda kompleksit të mbrojtur të Marashit, nuk janë duke iu përmbajtur kushteve të përcaktuara nga institucionet përgjegjëse të trashëgimisë kulturore dhe njëkohësisht këto punime janë duke e shkelur Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit.

Në bazë të projektit të siguruar në QRTK Prizren, EC vëren se te kulmi ka tejkalim në krahasim me projektin e dorëzuar në Komisionin e MKRS-së dhe me të cilën është siguruar leja për rindërtim të Teqes në Marash.

EC Ma ndryshe, në nëntor të vitit të kaluar bashkërisht edhe me konstatimet e QRTK Prizren pati reaguar ndaj mosnjohimit të investitorit ndaj QRTK-së për fillimin e punimeve si dhe tejkalimeve në ndryshim të morfologjisë së terrenit. Për më tepër shih [reagimin](#).

EC konsideron se institucionet qendrore përgjegjëse për trashëgimi kulturore bashkërisht me Komunën e Prizrenit duhet ti monitorojnë aktivitetet ndërtimore në Qendrën Historike të Prizrenit. Për më tepër EC i bën thirrje Inspektoratit të MKRS-së dhe atij të Komunës së Prizrenit që ti evidentojnë tejkalimet në projektet e aprovuara dhe të marrin masa sipas dispozitave ligjore përkatëse.

Prerja e objektit në projekt ku nuk shihet baxha/konstruksioni shtesë në kulm



Fotografia e investitorit ne punishte ku vërehet se nuk ka baxhë/konstruksion shtesë në kulm



Gjendja në terren

